



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 113, datë 29.08.2014**

**PËR  
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT  
“INSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 22, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, dhe nenit 57, paragrafi 2, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e disa ndryshimeve të statutit të shoqërisë së sigurimit “Insig” sh.a., sipas tekstit bashkëngjitur.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Enkeleda SHEHI**

## **Ndryshimet në statutin e shoqërisë së sigurimit “Insig” sh.a.:**

1. Neni 1 “Forma” riformulohet: *Instituti i Sigurimeve sh.a. (INSIG sh.a.), është shoqëri aksionare e krijuar në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe është organizuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë aktivitetin e shoqërive tregtare që veprojnë në fushën e sigurimeve dhe risigurimeve dhe këtij Statuti”.*
2. Neni 3 ndryshon si më poshtë:

Neni 3

“Selia, filialet, degët, pikat e shitjes dhe agjencitë”:

  - a. *Shoqëria ka selinë e saj në adresën ABA Center, Rr. Papa Gjon Pali II, kati i gjashtë, e emërtuar zyra nr. 600, Tiranë, Shqipëri;*
  - b. *Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është: [www.insig.com.al](http://www.insig.com.al);*
  - c. *Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj, nëpërmjet filialeve, degëve, pikave të shitjes së agjencive, të cilat krijohen me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë;*
  - d. *Degët, pikat e shitjes ose agjencitë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë do të veprojnë nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë;*
  - e. *Degët jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të mbikëqyren sipas rregullave të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.*
3. Neni 4 “Objekti”, paragrafi i parë riformulohet: *Shoqëria ka për objekt kryerjen e të gjitha veprimtarive të sigurimit dhe risigurimit të parashikuara në Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe akteve normative të dala në zbatim të tij.*
4. Neni 12 “Emërimi i Drejtorit të Përgjithshëm” bëhen këto ndryshime:
  - a. Paragrafi i parë riformulohet: *Drejtori i Përgjithshëm emërohet në detyrë për një periudhë 2 (dy) vjeçare nga Këshilli Mbikëqyrës në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe veçanërisht me ato të Ligjit për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit;*
  - b. Paragrafi i dytë hiqet;
  - c. Emërtesa “Zëvendësi i tij” hiqet në të gjithë përmbajtjen e këtij neni.
5. Neni 13 “Funksionet dhe kompetencat” bëhen këto ndryshime:
  - a. Emërtesa “zëvendësi i tij” hiqet në të gjithë përmbajtjen e këtij neni;
  - b. Paragrafi i dytë riformulohet: *Këshilli mbikëqyrës mund të kufizojë kompetencat dhe të drejtat e Drejtorit të Përgjithshëm;*
  - c. Paragrafi i fundit riformulohet: *Drejtori i Përgjithshëm në zbatim të strukturës organizative të shoqërisë miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës emëron Drejtorët e Departamenteve, të Degëve, Pikave të Shitjes apo Agjencive brenda territorit të*

*Republikës së Shqipërisë. Drejtorët e Departamenteve emërohen pasi të merret pëlqimi paraprak i Këshillit Mbikëqyrës.*

6. Neni 14 “Shkarkimi i Drejtorit të Përgjithshëm” emërtesa “zëvendës i tij”, hiqet në të gjithë përmbajtjen e këtij neni.
7. Neni 18 “Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës” bëhen këto ndryshime:
  - a. Paragrafi “a” riformulohet: *Këshilli Mbikëqyrës zhvillon mbledhjet në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjetër të caktuar nga vet Këshilli Mbikëqyrës. Si rregull i përgjithshëm, njoftimi për zhvillimin e mbledhjes bëhet 3 (tre) ditë përpara për datën, orën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes;*
  - b. Në paragrafin “g”, shprehja “... por jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e mbledhjes së parë”, zëvendësohet më shprehjen “.. por jo më vonë se 20 (njëzet) ditë nga data e mbledhjes së parë”.